



| | | | |
|---|-----------|-------------|---------------------|
| Pranuar / Dorezuar Punësimi / Proradato Received / Delivery | 09 - 11 | 3 | viti god year |
| Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit | SKPM/SHCK | 6951 / 2023 | 1 / 4 |



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1187/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1187/2023 të datës 20.09.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] më adresë [redacted]

[redacted] kundër organit të punësimit/Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "Kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 09.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.1187/2023 e datës 20.09.2023 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke bërë kompensimin e pagës në vlerën 50% për ankuesin [redacted] sipas kërkesës së datës 09.02.2023 të Komunës së Prishtinës, dhe atë nga data 08.05.2018 deri më datë 01.01.2023.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit [redacted] i punësuar sipas Akt Emërimit me numër 01 nr.112-244 të datës 01.02.2017 në pozitën "Zyrtar për Leje Ndërtimore" në Komunën e Prishtinës, Kryetari i Komunës së Prishtinës, pas marrjes së njoftimit të datës 03.05.2018 nga Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prishtinë se ndaj tij është ngritur aktakuzë për keqpërdorim të detyrës zyrtare,

më datë 08.05.2018 ka nxjerr Vendim me Nr. 14-118/02-0108572/18 përmes të cilit ka bërë pezullimin parandalues me 50% të pagës deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 20.10.2022 ka nxjerr Aktgjykim PKR.nr.13/18 me të cilin ankuesin e ka liruar nga akuza, ndërsa Kryetari i Komunës së Prishtinës bazuar në këtë aktgjykim më datë 21.12.2022 ka nxjerr Vendim me Nr. 14-101-03-273524/22 përmes të cilit ankuesi është kthyer në vendin e punës në pozitën "Zyrtar për Leje Ndërtimore" nga data 01.01.2023 duke i'u njohur e drejta për kompensim të 50% të pagës nga data 08.05.2018.

Komuna e Prishtinës më datë 09.02.2023 ka përgatitur kërkesën për pagesë të pagave ndërsa këtë e ka dërguar më datë 11.02.2023 në Thesarin e Kosovës për ekzekutim, ndërsa Udhëheqësi i Sektorit për Buxhet dhe Financa i Komunës së Prishtinës përmes emailit të datës 16.03.2023 ka kërkuar nga zyrtarët e Thesarit të Kosovës të njoftohen lidhur me pagesën në fjalë, poashtu më datë 16.08.2023 Zyrtari i Lartë për Burime Njerëzore ka njoftuar zyrtarët e Thesarit se është krijuar baza për pagesë sipas kërkesës së muajit Shkurt 2023.

Ankuesi kundër mos pagesës, më datë 20.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 6165/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 25.09.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës. Ndërsa Këshilli me datë 04.10.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Për shkak të kompleksitetit të lëndës, më datë 31.10.2023 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr Vendim për zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 6165/2020 të datës 20.09.2020 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 28.01.2023 nga [] për [] dhe [] Emailin e datës 11.02.2023 nga [] për [] dhe [] Emailin e datës 16.03.2023 nga [] për [] dhe [], Emailin e datës 16.08.2023 nga [] për [] dhe [] Kërkesë për pagesë të pagave dhe kontributeve për nëpunësit publik të kthyer në punë e datës 09.02.2023 dërguar për zv. Drejtorin e Thesarit; Vendimin e datës 26.04.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Konstatimin e datës 04.02.2023; Vendimin me Nr. 14-101-03-273524/22 të datës 21.12.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Aktgjykimin PKR.nr.13/18 të datës 20.10.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë; Kërkesë për pagesë retroaktive shkurt 2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.09.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 04.10.2023; Vendimin me Nr.14-118/02-0108572/18 të datës 08.05.2018 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës; Akt Emërimit 01 nr.112-244 të datës 01.02.2017.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave



materiale të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse*:

Ankuesi në ankesën e parashtruar më datë 20.09.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se nuk është zbatuar Vendimi me Nr. 14-101-03-273524/22 i datës 21.12.2022 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës përmes të cilit përveç kthimit në vendin e punës më është njohur edhe e drejta e kompensimit të 50% të pagës për periudhën 08.05.2018 deri 01.01.2023.

Duke marr parasysh faktin se ankuesi sipas Aktgjykimit PKR.nr.13/18 të datës 20.10.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Krimeve të Rënda, është liruar nga akuza, atëherë sipas Kolegjit të Këshillit, edhe pretendimit ankimor të ankuesit për kompensimin e pjesës prej 50% të pagës sipas Vendimit me Nr. 14-101-03-273524/22 të datës 21.12.2022 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është i bazuar në kuptim të nenit 69 paragrafi 3 të Ligjit të aplikuar në këtë periudhë Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku ishte përcaktuar se: *"Nëse nëpunësi përkatës civil më pas rikthehet në shërbim, qoftë për shkak se akuza kundër tij/saj nuk ka mundur të dëshmohet, për shkak të dyshimit ose arsyeve të tjera teknike, ai/ajo duhet të konsiderohet se është pezulluar nga ushtrimi i detyrës"*, ngase në bazë të këtij paragrafi të këtij neni periudha e mungesës në punë do të trajtohet si periudhë e qëndrimit në detyrë për të gjitha qëllimet dhe nëpunësi civil duhet të kompensohet me pagë të plotë sikur ai/ajo do t'i kishte marrë nëse nuk do të ishte pezulluar nga shërbimi, kështu që sipas Kolegjit të Këshillit, ligjërisht ankuesit i takon kompensimi i 50% të pagës nga data 08.05.2018 deri në kthimin në vendin e punës.

Meqenëse Komuna e Prishtinës, respektivisht Kryetari i Komunës sipas Vendimit me Nr. 14-101-03-273524/22 të datës 21.12.2022, ka ndërmarr të gjitha veprimet ligjore që përveç kthimit të ankuesit në vendin e punës, ka vendosur t'i njihet e drejta e kompensimit të 50% të pagës nga dita e pezullimit dhe megjithëse ky vendim po ashtu edhe kërkesa e datës 09.02.2023 me gjithë dokumentacionin përkatës është dërguar për ekzekutim në Thesarin e Kosovës duke u kërkuar edhe disa herë se në cilën fazë është procedimi i pagesave, atëherë Kolegji i Këshillit në kuptim të respektimit të normave ligjore të cekura si më lartë konstaton se Komuna e Prishtinës ka përmbushur obligimin ligjor ndaj ankuesit duke ndërmarrë veprimet e nevojshme administrative, ndërsa tani çështja e ekzekutimit të kompensimit të 50% të pagës për ankuesin bazuar në legjislacionin në fuqi të zyrtarëve publik si dhe vendimin Nr. 14-101-03-273524/22 të datës 21.12.2022 të Zyrtarit Kryesor Administrativ të Komunës së Prishtinës bie në barrë për zbatim të Thesarit të Kosovës, kështu që sipas këtij vendimi obligohet Drejtori i Thesarit të Kosovës që në kuptim të kërkesës së datës 09.02.2023 të Komunës së Prishtinës të bëjë kompensimin e pagave për ankuesin në vlerën 50% nga dita e pezullimit të marrëdhënies së punës deri në ditën e kthimit në punë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave përkundër që në ankesë ka pasur edhe disa pretendime tjera por që nuk ishin me relevancë për trajtim për faktin se nuk ishte argumentuar me prova konkrete pretendimi në lidhje me këto çështje, andaj bazuar në shkresat e lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.



Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1187/2023, datë 09/11/2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.